

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar  
Advanced Financial Reporting

**P9**

Nr.

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data  
18.06.2016

## CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u></b>
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

## Problemi 1

Armstrong njihet për blerjen e bizneseve dhe shitjen e tyre me fitim brenda një periudhe dy deri në tre vjeçare pas blerjes së tyre.

Me 1 tetor 2012 bleu 80% të aksioneve të zakonshme të Aldrin për €30 milion kur fitimet e mbajtura ishin €5 milion dhe vlera e drejtë e pasurive të Aldrin ishte e barabartë më shumat bartëse. Zëri i mirë i Aldrin nuk ishte dëmtuar.

Me 1 tetor 2014 Armstrong bleu 60% të aksioneve të zakonshme të Collins. Konsiderata e blerjës ishte si në vijim:

- Një pagesë e menjëhershme në para prej €10 milion.
- Një këmbim i 2 aksioneve të Armstrong për 3 aksione të blera të Collins ku çmimet e tregut të një aksioni të Armstrong dhe Collins ishin €3 dhe €2 respektivisht.
- Një pagesë e shtyer prej 11 cent për çdo aksion të blere e pagueshme me 1 tetor 2015.

Transaksioni i mësipërm nuk është regjistruar në librat e Armstrong përveç pagesës së menjëhershme të parasë. Armstrong ka një kosto të kapitalit prej 10% në vit.

Një vlerësim i vlerës së drejtë është bërë për pasuritë jo-qarkulluese të Collins në datën e blerjës me rezultatet si në vijim:

	Vlera bartëse (€)	Vlera e drejtë (€)
Toka	4.0 milion	4.5 milion
Impianti	3.0 milion	4.0 milion

Impianti kishte një jetë të mbetur të përdorimit prej 5 vite. Një zhvlerësim i terë vitit është bërë pas periudhës së blerjes.

Vlera e drejtë e tokës së lartpërmendur është rritur gjatë periudhës pas blerjes edhe për €1 milion të tjera. Është politikë e grupit që të tregoj të gjitha pasuritë jo-qarkulluese sipas vlerës së drejtë.

Draft pasqyrat e përmbledhura financiare të të tri kompanive janë si më poshtë:

### Pasqyrat e Fitimit dhe Humbjës për vitin e përfunduar me 30 shtator 2015

	Armstrong €'000	Aldrin €'000	Collins €'000
Të hyrat	120,000	52,000	34,800
Kosto e shitjeve	<u>(72,000)</u>	<u>(18,000)</u>	<u>(9,000)</u>
Fitimi bruto	48,000	34,000	25,800
Shpenzimet operative	(4,900)	(4,400)	(5,000)
Fitimi para tatimit	<u>43,100</u>	<u>29,600</u>	<u>20,800</u>
Tatimi	<u>(6,000)</u>	<u>(1,600)</u>	<u>(1,200)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>37,100</b>	<b>28,000</b>	<b>19,600</b>

## Pasqyrat e Pozitës Financiare me 30 shtator 2015

	<b>Armstrong</b>	<b>Aldrin</b>	<b>Collins</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Pasuritë jo-qarkulluese	67,000	35,500	12,000
Investimet	40,000	26,000	
Pasuritë qarkulluese	<u>31,000</u>	<u>16,500</u>	<u>39,500</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>138,000</b>	<b>78,000</b>	<b>51,500</b>
Ekuiteti dhe detyrimet			
Aksione të zakonshme €1 secila	50,000	30,000	10,000
Fitimet e mbajtura	22,000	38,000	27,000
Premia e aksioneve	20,000		
Llogaria pezull – të hyrat nga shitja e aksioneve në Aldrin	22,000		
Detyrimet afatshkurtëra	<u>24,000</u>	<u>10,000</u>	<u>14,500</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>138,000</b>	<b>78,000</b>	<b>51,500</b>

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

(i) Me 1 prill 2015, Armstrong shiti 12 milion aksione në Aldrin për €22 milion. Armstrong pranoi paratë por ka kredituar llogarinë e përkohshme.

(ii) Një test i dëmtimit i kryer me 30 shtator 2015 tregoi se zëri i mirë i konsoliduar i Collins ishte dëmtuar për €2 milion.

(iii) E përfshirë në detyrimet afatshkurtëra të Collins është dividend e propozuar e pagueshme prej €2 milion. Dividenda është paguar nga fitimet pas blerjes. Armstrong nuk e ka njohur ende pjesen e tij të dividendës së arkëtueshme nga Collins. Me 31 gusht 2015 Armstrong deklaroi një dividend finale prej €1 milion. Kjo nuk është regjistruar në librat e Armstrong.

(iv) Gjatë vitit, Armstrong shiti mallra që kushtuan €4 milion për €6 milion tek Collins. 20% e këtyre mallrave mbetën të pashitura me 30 shtator 2015. Collins i kishte një borxh prej €2 milion ndaj Armstrong. Me 29 shtator 2015, Collins dërgoi një çek tek Armstrong prej €1 milion. Ky nuk është pranuar nga Armstrong deri me 5 tetor 2015.

(v) Supozo që të ardhurat dhe shpenzimet ndodhin njëtrajtësisht përgjatë vitit.

(vi) Armstrong llogarit zërin e mire duke përdorur metodën proporcionale.

### Kërkohet:

**Përgatiteni Pasqyrën e Konsoliduar të të Ardhurave për vitin e përfunduar me 30 shtator 2015, Pasqyrën e Konsoliduar të Ndryshimeve në Ekuitet dhe Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare me 30 shtator 2015.** (Total: 25 pikë)

## Zgjidhja e problemit 1

### Investimet në Aldrin - 80%

Konsiderata	€'000
Paraja	30,000
Minus:	
Aksionet e ekuitetit	(24,000)
Fitimet e mbajtura	<u>(4,000)</u>
Zëri i mirë	2,000

### Shitja e 12 milion aksioneve në Aldrin (50%)

Në Posedim	€'000
Të ardhurat nga shitja	22,000
- Kosto e investimit 30,000 x 50%	<u>(15,000)</u>
Fitimi nga shitja	7,000

Grupi	€'000
Të ardhurat nga shitja	22,000
Minus:	
Aksionet e ekuitetit	30,000
Fitimet e mbajtura s/f	10,000
Fitimet deri në datën e shitjes	14,000
<b>54,000 x 40%</b>	<u>(21,600)</u>
	400
Zëri i mirë 2,000 x 50%	<u>(1,000)</u>
<b>Humbja nga shitja</b>	<b>(600)</b>

**Investimet në Collins - 60%**

Konsiderata		<b>€'000</b>
Paraja		10,000
Këmbimi i aksioneve	$6,000/3 \times 2 \times 3\text{€}$	12,000
Pagesa e shtyrë	$11 \text{ cent} \times 6,000 \times 1/1.1$	<u>600</u>
		22,600
Minus:		
Aksionet e ekuitetit		(6,000)
Fitimet e mbajtura	$27,000 + 2,000 = 29,000$	
Fitimi pas tatimit	<u>(19,600)</u>	
1/10/12 para blerjes	9,400	
	x 60%	(5,640)
Riv. Toka	$500 \times 60\%$	(300)
Riv. Impianti	$1,000 \times 60\%$	(600)
Zëri i mirë		10,060
Dëmtuar		<u>(2,000)</u>
Zëri i mirë te PKPF		8,060

**Fitimet e mbajtura - Collins**

	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	27,000
Fitimet para blerjës	(5,640)
Zhvlerësimi shtese	(200)
IJK $27,000 - 200 \times 40\%$	<u>(10,720)</u>
Pas blerjës - PKA	10,440

**Fitimet e mbajtura - Armstrong**

	<b>€'000</b>
Saldo në fillim	22,000
Plus: nga Collins	10,440
Dividendat e arkëtueshme nga Collins	1,200
Pjesa e fitimit të ortakërisë	13,200
Fitimi në shitje	7,000
Minus:FPR	(400)
Zëri i mirë i dëmtuar - Collins	(2,000)
Interesi në konsideratën e shtyrë	(60)
Dividenda finale	<u>(1,000)</u>
Tek PKPF	50,380

**Investimet në ortakëri - 40%**

	€'000
Kosto e Investimit	15,000
Pjesa e fitimeve pas blerjës 38,000 - 5,000 x 40%	<u>13,200</u>
Tek PKPF	28,200

**Interesi jo-kontrollues - 40%**

	€'000
Ekuiteti	4,000
Fitimet e mbajtura	10,720
Riv. toka 500 x 40%	200
Riv. Impianti 1,000 x 40%	400
Rivleresimi i mepasëm 1,000 x 40%	<u>400</u>
Tek PKPF	15,720

**Pasqyra e konsoliduar të të ardhurave për vitin e përfunduar me 30 shtator 2015**

	€'000
Të hyrat $120,000 + 52,000 \times 6/12 + 34,800 - 6,000$	174,800
KSH $72,000 + 18,000 \times 6/12 + 9,000 - 6,000 + \text{FPR } 400$	<u>(84,400)</u>
FB	90,400
Minus humbja nga shitja	<u>(600)</u>
	89,800
Shpenzimet operative $4,900 + 4,400 \times 6/12 + 5,000 + \text{zhvlerësimi } 200$ + zëri i mirë 2,000 + interesi 60	<u>(14,360)</u>
FPT	75,440
Pjesa e fitimi të ortakërisë $28,000 \times 6/12 \times 40\%$ 5,600	81,040
Tatimi $6,000 + 1,600 \times 6/12 + 1,200$	<u>(8,000)</u>
Fitimi për vitin	73,040
Atribuar:	€'000
IJK Aldrin $28,000 \times 6/12 \times 20\%$	2,800
Collins $19,600 - 200 \times 40\%$	7,760
Mbajtësve të ekuitetit të prindit	<u>62,480</u>
	73,040

**Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Ekuitet për vitin e përfunduar me 30 shtator 2015**

	€'000
Fitimet e mbajtura në fillim	(15,100)
Armstrong	(15,100)
Aldrin $10,000 - 5,000 \times 80\%$	<u>4,000</u>
	(11,100)
Fitimi i vitit	62,480
Dividendat	<u>(1,000)</u>
Fitimet e mbajtura s/fund	50,380

<b>Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 30 shtator 2015</b>	<b>€'000</b>
Pasuritë jo-qarkulluese $67,000 + 12,000 + (\text{Riv. } 1,000 + 500 + 1,000) - 200$ (zhvlerësimi)	81,300
Zëri i mirë	8,060
Investimet në ortakëri	28,200
Pasuritë qarkulluese $31,000 + 39,500 - \text{FPR } 400 - 2,000 + 1,000$	<u>69,100</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>186,660</b>
Ekuiteti $50,000 + 4,000$	54,000
Premia e aksioneve $8,000 + 20,000$	28,000
RR	600
PKFH	50,380
IJK	15,720
Detyrimet afatshkurtëra $24,000 + 14,500 - \text{dividend e pagueshme } 2,000 - 1,000 + 1,000$	36,500
Dividenda ndaj IJK	800
Pagesa e shtyrë	<u>660</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>186,660</b>

## Problemi 2

a) Xhaka sh.p.k është një kompani e përfshirë në industrinë e sportit, e cila i përgatitë pasqyrat e saj financiare me 31 dhjetor çdo vit.

### Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2015

	Vlera në libra	Baza tatimore
<u>Pasuritë jo-qarkulluese</u>	€ '000	€'000
Prona, fabrika dhe paisjet	1,440	960
Shpenzimet e kapitalizuara të zhvillimit	<u>4,920</u>	<u>0</u>
	6,360	960
<u>Pasuritë qarkulluese</u>		
Banka	<u>96</u>	<u>96</u>
	<b>6,456</b>	<b>1,056</b>
<u>Ekuiteti dhe detyrimet</u>		
Kapitali aksionar	120	120
Fitimet e mbajtura	<u>3,096</u>	<u>96</u>
	3,216	216
<u>Detyrimet afatgjata</u>		
Grantet qeveritare	2,400	0
Tatimi i shtyrë (detyrimet me 1.1.2015)	<u>816</u>	<u>816</u>
	3,216	816
<u>Detyrimet afatshkurtëra</u>		
Të pagueshmet tregtare	<u>24</u>	<u>24</u>
	<b>6,456</b>	<b>1,056</b>

### Informata shtesë

- i) Drejtorët vendosën të regjistrojnë pronën në shumën e rivlerësuar me efekt prej 31 dhjetor 2015. Vlera e drejtë e pronës me 31 dhjetor 2014 ishte €600,000 me shumë se sa vlera në libra më sipër.
- ii) Shpenzimet e zhvillimit prej €4,920,000 të treguara më sipër janë kapitalizuar në pajtim me SNK 38. Këto kosto janë një shpenzim i lejueshëm tatimor në periudhën në të cilën kanë ndodhur.
- iii) Grantet qeveritare nuk janë të tatueshme.
- iv) Norma e tatimit është 25%.

**Kërkohet:**

**Kalkulo shpenzimet e tatimit të shtyrë dhe pasuritë ose detyrimet e tatimit të shtyrë me 31 dhjetor 2015. (10 pikë)**

b) Arsenal sh.p.k ka hyrë në një marrëveshje të lizingit, detajet e së cilës janë si në vijim: 3 pagesa të lizingut prej €40,000 do të bëhen çdo vit në fillim të vitit dhe një pagesë përfundimtare prej €30,000 do të bëhet në fund të periudhës 3 vjeçare. Norma e nënkuptuar (implicite) e interesit është 10%.

	Faktori i skontimi 10%
Viti 0	1.000
Viti 1	0.909
Viti 2	0.826
Viti 3	0.751

**Kërkohet:**

**Kalkulo shumën e shpenzimit të interesit që do të njihet në vitin e parë? (5 pikë)**

**Total (15 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 2

2. a)	Vlera në libra	Baza tatimore	Diferenca e përkohshme e tatueshme
	'000	'000	'000
Prona, fabrika dhe paisjet	2,040	960	1,080
Shpenzimet e kapitalizuara të zhvillimit	4,920	0	4,920
Banka	96	96	0
Grantet Qeveritare	2,400	0	0
Tatimi i shtyrë (detyrim me 1 janar 2015)	(816)	(816)	0
Të pagueshmet tregtare	(24)	(24)	
			<u>6,000</u>
Detyrimi i tatimit të shtyrë @ 25%			1,500
Saldo në fillim			<u>(816)</u>
Levizjet			684
Ndarja-të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse (Tatimi i shtyrë në fitimi nga rivlerësimi) 600 x 25%			<u>(150)</u>
Pasqyra e Fitimit ose Humbjeve dhe të Ardhurat tjera Gjithëpërfshirëse			534

## b)

Duhet llogaritur vlerën e taishme të pagesave minimale të lizingut

	Pagesat	Norma e skontimi 10%	Vlera e tanishme		
Viti 0	40,000	0	40,000		
Viti 1	40,000	0.909	36,360		
Viti 2	40,000	0.826	33,040		
Viti 3	30,000	0.751	<u>22,530</u>		
			<b>131,930</b>		
	<i>Detyrimi në fillim</i>	<i>Pagesat</i>	<i>Kryegjëja e mbetur</i>	<i>Interesi 10%</i>	<i>Detyrimi në fund</i>
Viti 1	131,930	40,000	91,930	9,193	101,123

**Përgjigja 9,193**

### **Problemi 3**

Lucky Clover sh.p.k filloi dy plane të pensioneve me 1 janar 2014, planin 'Mini' për stafin menaxherial dhe planin 'Max' për punonjësit e tjerë. Detajet e secilit plan janë si në vijim:

#### **Plani Mini**

Sipas këtij plani, Lucky Clover sh.p.k-së i kërkohet të bëjë pagesa fikse vjetore të kontributeve në fond. Përveç kësaj, obligimi i saj ligjor apo i tërthortë është i kufizuar në kontributet fikse që duhet t'i bëjë në fond. Për më tepër, punonjësve u kërkohet të kontribuojnë 10% të totalit të kontributeve pensionale në skemë.

Me 1 janar 2014, kontributet totale prej €100 milion ishin paguar në fond. Këto paraqesin kontribute të pensioneve për tri (3) vite. Kompania shpenzoi të gjitha shumat në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 30 shtator 2014. Në anën tjetër, asnjë shumë nuk është shpenzuar në vitin deri me 30 shtator 2015.

Skema kishte vlerë të drejtë të pasurive të planit prej €100 milion dhe vlerë të tanishme të obligimeve të planit prej €120 milion me 1 janar 2014. Saldo e vlerës së drejtë të pasurive të planit dhe vlera e tanishme e obligimeve të planit u rritën në €110 milion dhe €140 milion respektivisht me 30 shtator 2015. Këto nuk janë regjistruar askund në librat e Lucky Clover sh.p.k.

#### **Plani Max**

Kushtet e këtij plani kërkojnë që Lucky Clover sh.p.k të garantoj përfitimet pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës për punonjësit e saj.

Vlera e drejtë e pasurive të planit dhe vlera e tanishme e obligimeve të planit arritën shumën në €140 milion dhe €190 milion respektivisht me 30 shtator 2014. Saldot me 30 shtator 2015 ishin €195 milion për vlerën e drejtë të pasurive të planit dhe €210 milion për vlerën e tanishme të obligimeve të planit. Me 1 janar 2014, vlera e drejtë e pasurive të planit ishte e barabartë me kontributet e paguara nga Lucky Clover sh.p.k në fond që arrinin shumën prej €100 milion. Vlera e tanishme e obligimeve të planit ishte vlerësuar €120 milion në po të njejtën datë.

Gjatë vitit deri me 30 shtator 2015 kompania zvogëloi përfitimet në të cilat punonjësit kanë të drejtë sipas këtij plani për €20 milion. Kjo shumë ishte €12 milion një vitin më herët. Vlera e tanishme e obligimeve të planit u rrit për €18 milion dhe €19 milion në vitet e përfunduara me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015 respektivisht. Për më tepër, kompania kontriboi një shumë totale prej €40 milion me 1 tetor 2014.

Nuk janë paguar përfitime të pensioneve nga kompania në të dy vitet.

Kompania regjistroi në pasqyrat financiare për vitet deri me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015 vlerën e drejtë të pasurive të planit si pasuri themelore dhe vlerën e tanishme të obligimeve të

planit si detyrime afatgjata. Diferencat ndërmjet vlerës së tanishme të obligimeve të planit dhe vlerës së drejtë të pasurive të planit janë dërguar në pasqyrën e fitimit ose humbjës ose si zë i të ardhurave ose si zë i shpenzimeve. Kontributet e paguara janë kontabilizuar drejtë në pasqyrat financiare. Megjithatë, zërat tjerë lidhur me planit e pensione nuk janë regjistruar në pasqyrat financiare.

Norma vjetore e skontimit për vitin deri me 30 shtator 2014 ishte 10% dhe 12% për vitin deri me 30 shtator 2015.

**Kërkohet:**

**(i) Shpjego dallimin ndërmjet një plani me kontribute të paracaktuara dhe një plani me përfitime të paracaktuara. (5 pikë)**

**(ii) Shpjego trajtimin në kontabilitet të të dy planeve në pasqyrat financiare të Lucky Clover sh.p.k dhe hyrjet e kërkuara në kontabilitet për t'i kontabilizuar drejtë në pasqyrat financiare të vitit 2014 dhe 2015. (15 pikë)**

**(Total: 20 pikë)**

### Zgjidhja e problemit 3

3.

a) **Dallimi ndërmjet planit me përfitime të paracaktuara dhe planit me kontribute të paracaktuara.**

Në një plan më përfitime të paracaktuara kompania u garanton punonjësve përfitimet pas ndërprerjes së marrëdhënies së punësimit. Kjo nënkupton që nëse pasuritë e fondit nuk mjaftojnë për të mbuluar përfitimet e punonjësve, atëhere kërkohet nga punëdhënësi që të mbuloj mungesën. Andaj rreziku i investimit në plan mbetet me punëdhënësin. Për më tepër, punëdhënësi kontabilizon neto pasuritë e planit apo neto detyrimet e pensioneve në pasqyrat e tija financiare.

Sipas një plani me kontribute të paracaktuara, obligimi i punëdhënësit është i kufizuar në atë që është dakorduar si kontribut i tij në plan. Andaj rreziku i investimit mbetet tek punonjësit. Punëdhënësi kontabilizon vetëm kontributet në pasqyrat e tij financiare.

b)

#### **Plani Mini**

Ky është një plan i kontributeve të paracaktuara pasi që obligimi i Lucky Clover sh.p.k është i kufizuar në kontributet që duhet ti bëjë në plan. Duhet të kontabilizoj vetëm kontributet e bëra nga kompania në fond. Kontributet e bëra nga punonjësit në fond duhet të përjashtohen nga pasqyrat financiare.

Kontributet totale prej €90 milion (90% x €100m) të bëra nga kompania për mbulimin e periudhës tre vjeçare nuk duhet të kontabilizohen në një periudhë të kontabilitetit por të shpërndahen përgjatë periudhës të cilës i përkasin shumat, që është tre vite.

Shumat prej €22.5 milion (€90m/3vite x 9/12) dhe €30 milion (€90m/3vite) duhet të njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjës për vitet deri me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015 respektivisht. Kjo nënkupton që një shumë prej €77.5 milion (€100m - €22.5m) duhet të stornohet për periudhën deri me 30 shtator 2014. Një parapagim prej €67.5 milion dhe €37.5 milion duhet të njihet në pasqyrën e pozitës financiare me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015 respektivisht. Pasuritë e planit ose obligimet e planit nuk do të njihen në pasqyrat financiare të Lucky Clover sh.p.k.

#### **Plani Max**

Ky është një plan me përfitime të paracaktuara. Kjo për shkak se Lucky Clover sh.p.k u garanton punonjësve të saj përfitimet pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Kjo nënkupton që rreziku i investimit mbetet tek Lucky Clover sh.p.k.

Kompania është dashur të njohë një detyrim neto të planit prej €50m (L15) me 30 shtator 2014 dhe €15m (L15) me 30 shtator 2015. Andaj, €140m (190 - 50) dhe €195m (210 - 15) duhet të zbriten nga detyrimet afatgjata me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015 respektivisht. Për më tepër, Lucky Clover sh.p.k nuk është dashur të njohë ndonjë pasuri me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015. €140m dhe €195m të regjistruara në pasuritë themelore duhet të stornohen në pasqyrën e pozitës financiare me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015 respektivisht.

Gjithashtu, Lucky Clover sh.p.k është dashur të njohë shpenzime neto prej €127.5m (LL3) dhe €0.2m (L13) në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015 respektivisht. €50m (190 - 140) humbje dhe €15m (210 - 195) humbje janë njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015 respektivisht. €42.5m (50 - 7.5) dhe €14.8m (15 - 0.2) duhet të kreditohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes apo në fitimet e mbajtura për vitin deri me 30 shtator 2014 dhe 30 shtator 2015 respektivisht.

## Llogaritjet

### L11 Vlera e drejtë e pasurive të planit

€'milion

1 janar 2014	Kontributet e paguara	100
30 shtator 2014	Kthimi 10% x 100 x 9/12	7.5
30 shtator 2014	Fitimet nga vler. e eksp. (shif.bal)	<u>32.5</u>
<b>Saldo me 30 shtator 2014</b>		<b>140</b>
1 tetor 2014	Kontributi i paguar	40
30 shtator 2015	Kthimi 12% x (140+40)	21.6
30 shtator 2015	Humbjet nga vler. e eksp. (shif.bal)	<u>(6.6)</u>
<b>Saldo me 30 shtator 2015</b>		<b>195</b>

### L12 Vlera e tanishme e obligimeve të planit

€'milion

Saldo me 1 janar 2014	(Kostot e shërbimeve të kaluara)	120
30 shtator 2014	Interesi 10% x 120 x 9/12	9
30 shtator 2014	Kostot e shërbimeve aktuale	18
30 shtator 2014	Kostot e shërbimeve të kaluara	(12)
30 shtator 2014	Humbjet nga vler. e eksp. (shif.bal)	<u>55</u>
<b>Saldo me 30 shtator 2014</b>		<b>190</b>
30 shtator. 2015	Interesi 12% x 190	22.8
30 shtator 2015	Kostot e shërbimeve aktuale	19
30 shtator 2015	Kostot e shërbimeve të kaluara	(20)
30 shtator 2015	Fitimet nga vler. e eksp. (shif.bal)	<u>(1.8)</u>
<b>Saldo me 30 shtator 2015</b>		<b>210</b>

**L13 Neto shpenzimet**

	30 shtator	
	2014	2015
	€'milion	€'milion
Interesi L12	9	22.8
Kthimi L11	(7.5)	(21.6)
Kostot e shërbimeve aktuale	18	19
Kostot e shërbimeve të kaluara (120-12)	<u>108</u>	<u>(20)</u>
Neto shpenzimet	127.5	0.2

**L14 Neto fitimet nga vlerësimet e ekspertit**

	30 shtator	
	2014	2015
	€'milion	€'milion
Humbjet/ (fitimet) nga vler. e eksp.:		
Vlera e drejtë e pasurive të planit L11	(32.5)	6.6
Vlera e tanishme e obligimeve të planit L12	<u>55</u>	<u>(1.8)</u>
Neto humbjet nga vlerësimet e ekspertit	22.5	4.8

**L15 Neto detyrimet e planit**

	30 shtator	
	2014	2015
	€'milion	€'milion
Vlera e tanishme e obligimeve të planit	190	210
Vlera e drejtë e pasurive të planit	<u>(140)</u>	<u>(195)</u>
Neto detyrimet e planit	50	15

#### **Problemi 4**

Fitimi pas tatimit i XXL sh.a gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2015 ishte €127.83 milion. Numri mesatar i ponderuar i aksioneve gjatë vitit ishte 85.22 milion.

Detajet e aksioneve të zakonshme potenciale me 31 dhjetor 2015 janë si në vijim:

1. Kompania ka emetuar obligacione të cilat mund të konvertohen në 3 milion aksione të zakonshme. Mbajtësit e obligacioneve mund të ushtrojnë opcionin e tyre me 31 dhjetor 2017. Nëse obligacionet nuk konvertohen në aksione të zakonshme ato ripaguhën me 31 dhjetor 2017. Interesi në obligacione gjatë vitit 2015 ishte €7.5 milion.
2. Aksionet preferenciale të emetuara në vitin 2012 janë të konvertueshme në 4 milion aksione të zakonshme në opcion të aksionarëve preferencial. Opcioni i konvertimit është i ushtrueshëm me 31 dhjetor 2018. Dividenda e paguar për aksionet preferenciale gjatë vitit 2015 ishte €2.45 milion.
3. Kompania ka emetuar opzione (kontrata me mundësi zgjedhjeje) të cilat bartin të drejtën e blerjes së 1.5 milion aksioneve të zakonshme me apo pas 31 dhjetorit 2015 me një çmim prej €9.90 për aksion. Gjatë vitit 2015, çmimi mesatari tregut të aksioneve ishte €11 për aksion.

Kompani ka një normë të tatimit në fitim prej 30%.

#### **Kërkohet:**

**(a) Duke shqyrtuar/konsideruar ndarazi secilin nga tri rastet mësipër llogarite fitimin bazik dhe të tretur për aksion për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015. (15 pikë)**

**(b) Shpjego dallimet ndërmjet verzionit të butë, gjysëm të fortë dhe të fortë të Hipotesës së Efikasitetit të Tregut (5 pikë)**

**(Total: 20 pikë)**

#### Zgjidhja e problemit 4

4.

	Fitimi nga operacionet të zakonshme atribuar aksionarve të zakonshëm €	Aksione	FPA €
Fitimi bazik për aksion	125,380,000	85,220,000	1.471

#### Rasti 1

Fitimi shtese (€7.5m x 70%)	<u>5,250,000</u>		
Numri i aksioneve shtese		<u>3,000,000</u>	
	130,630,000	88,220,000	1.481
		Eshtë Anti Tretës andaj FPA e tretur	1.471

#### Rasti 2

Fitimi bazik për aksion	125,380,000	85,220,000	1.471
Fitimi shtese	<u>2,450,000</u>		
Numri i aksioneve shtese		<u>4,000,000</u>	
	127,830,000	89,220,000	1.43

#### Rasti 3

Fitimi bazik për aksion	125,380,000	85,220,000	1.471
Fitimi shtese	<u>0</u>		
Numri i aksioneve shtese		(1.5m x 1.1 / 11) <u>150,000</u>	
	125,380,000	88,370,000	1.418

b)

Forma e dobët sugjeron që çmimet e aksioneve reflektojnë të gjitha të dhënat e çmimeve të kaluara dhe asnjë formë e analizës teknike nuk mund të përdoret efektivisht për t'i ndihmuar investitorët në marrjen e vendimeve të tregtimit.

Forma gjysëm e fortë e teorisë së efikasitetit ndjek supozimin që pasi të gjitha informatat që janë publike janë përdorur në llogaritjen e çmimit aktual të aksioneve, investitorët nuk mund të përdorin as analizat teknike e as ato fundamentale për të fituar kthime më të mëdha në treg.

Forma e fortë e hipotezës së efikasitetit të tregut thotë që të gjitha informatat – informatat në dispozicion të publikut si dhe ato që nuk janë të njohura për publikun – janë tërësisht të

përfshira në çmimet aktuale të tregut, dhe se nuk ka asnjë lloj të informatës që mund të i japë investitorëve një përparësi në treg.

## Problemi 5

(a) Specifiko kriteret për identifikimin e segmenteve operative, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. (3 pikë)

(b) Shqiponja sh.p.k është një kompani e integruar e prodhimit me pesë segmente operative. Informatat në vijim i takojnë vitit të përfunduar e 31 mars 2016:

Segmentet operative	Të hyrat e brendshme	Të hyrat e jashtme	Total të hyrat € në milion	Fitimi / (humbja)	Pasuritë	Detyrimet
A	38	705	743	194	200	130
B	-	82	82	(22)	44	40
C	-	300	300	81	206	125
D	35	-	35	10	75	60
E	38	90	128	(63)	50	25
<b>Total</b>	<b>111</b>	<b>1,177</b>	<b>1,288</b>	<b>200</b>	<b>575</b>	<b>380</b>

**Kërkohet:**

**Shpjego për secilin segment nëse është segment i raportueshëm.** (9 pikë)

c) Ju jeni këshilltar financiar i ACDC-së, një kompanie të listuar në bursë. Ju është kërkuar të këshilloni në disa çështje të kontabilitetit.

Në një mbledhje të bordit të mbajtur me 1 janar 2015, bordi i drejtorëve ka qenë i brengosur me rezultatet e dobëta të një njësie gjeneruese të parasë së kompanisë, divisioni TNT. Është vendosura në parim gjatë mbledhjes që ky division duhet të ndërpritet.

Zyrtari Kryesor Ekzekutiv i ACDC-së njoftoi për mbylljen e divizionit TNT gjatë një konference për shtyp të mbajtur me 15 shkurt 2015. Ai gjithashtu informoi që negociatat për ta shitur tërë divizionin janë duke vazhduar dhe pritet që shitja të finalizohet brenda pak muajve.

Me 14 qershor 2015, Zyrtari Kryesor Ekzekutiv raportoi në bord të drejtorëve që negociatat me Dinamiti sh.a janë duke vazhduar mirë dhe shitja e divizionit TNT pritet të materializohet para datës 31 korrik 2015. Megjithatë, pritet që pasuritë do të shiten me 95% të vlerës së tyre të drejtë.

**Kërkohet:**

**Shpjego se si transaksionet më sipër duhet të shpalosen ne pasqyrat financiare të ACDC- për vitin e përfunduar me 30 qershor 2015 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.** (8 pikë)

**Totali 20 pikë**

## Zgjidhja e problemit 5

5.

(a)

Një segment operativ është një komponent [përbërës] i një entiteti:

- i cili merret me aktivitete biznesi nga të cilat mund të gjenerohen të hyra dhe të ndodhin shpenzime (përfshirë të hyrat dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me transaksionet me komponentë [përbërës] të tjerë të të njëjtit entitet);
- rezultatet operative të të cilit rishikohen rregullisht nga vendim - marrësit kryesorë operativë [ekzekutivë] të entitetit të cilët marrin vendime për sa i takon burimeve që do të duhet të shpërndahen ndaj segmentit dhe vlerësojnë performancën e tij, dhe
- për të cilin janë në dispozicion informacione financiare të veçanta.

Një aktivitet biznesi i cili nuk ka të hyra, siç mund të jetë një biznes i sapofilluar, është segment operativ nëse raportohet ndarazi të zyrta kryesor të marrjes së vendimeve në operacione.

(b)

Entiteti duhet të raportojë veçmas informacionet që kanë të bëjnë me të gjitha segmentet operative të cilat:

- (a) Janë identifikuar si segmente që përmbushin përkufizimin e një segmenti operativ; dhe
- (b) Totalët e mëposhtme për segmentin janë 10 % ose më shumë të totalit të kompanisë për:
  - (i) Të hyrat (të brendshme dhe të jashtme), ose
  - (ii) Të gjitha segmentet që nuk raportojnë humbje (ose të gjitha segmentet që bëjnë humbje në qoftë se kjo e fundit është më e madhe), ose
  - (iii) Pasuritë

Të paktën 75 % e totalit të të hyrave të jashtme duhet të raportohen sipas segmenteve operative. Në rastet kur një gjë e tillë nuk është e mundur, duhet të identifikohen segmente shtesë (madje edhe në qoftë se nuk e arrijnë pragun prej 10 %).

Pasi që Shqiponja sh.p.k ka segmente që operojnë me fitim e po ashtu edhe me humbje, rezultatet e atyre me fitim dhe atyre me humbje duhet të mbledhen për të parë se cila është më e lartë:

$$\text{Fitime } (194+81+10) = 285$$

$$\text{Humbje } (22+63) = \frac{(85)}{200}$$

Andaj testi i fitimit apo humbjës prej 10% duhet aplikuar duke iu referuar shumës prej € 285 milion.

Segment i raportueshëm	(Po / Jo)	Shpjegim
A	Po	Sepse gjeneron më shumë së 10% të të hyrave.
B	Jo	Sepse nuk përmbush anjë nga kriteret e specifikuar në SNRF 8
C	Po	Sepse gjeneron më shumë së 10% të të hyrave.
D	Po	Sepse ka më shumë se 10% të pasurive.
E	Po	Sepse humbjet e tij janë më shumë se 10% të fitimeve absolute.

Verifikim nëse testi prej 75% është përmbushur:  $(705+300+90)/1,177 = 93\%$

c)

ACDC duhet ta klasifikoj TNT-në si një grup për shitje sepse vlera bartëse e TNT-së do të rikuperohet nga një transaksion i shitjës e jo nga përdorimi i vazhdueshëm. Kjo është një ngjarje korrigjuese sepse kushtet e mëposhtme të specifikuar në SNRF 5 janë përmbushur para fundit të vitit:

- (i) Grupi për shitje është në dispozicion për shitje në gjendjen aktuale. (Nuk ka ndonjë nëvoje/qëllim që të bëhen ndryshime të pasurisë para së të shitet)
- (ii) Shitja ka shumë gjasa të ndodhë duke pasur parasysh qëllimet e menaxhmentit, negociatat, çmimi është i arsyeshëm në raport me vlerën e drejtë, shitja pritet të ndoshë brenda një viti dhe nuk pritet ndonjë ndryshim në plan.

Andaj, TNT duhet të regjistrohet si e “mbajtur për shitje” në pasqyrat financiare të ACDC-së dhe shpalosjet përkatëse duhet të jenë si në vijim:

- (i) Një shumë e vetme në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse që përfshin totalin e
  - fitimit apo humbjës pas tatimit të operacionit të ndërprerë dhe
  - fitimit apo humbjës pas tatimit të njohur nga matja e vlerës së drejtë minus kostot e shitjës.
- (ii) Një analizë të shumës së vetme të referuar në pikën (i) mësipër, në:
  - Të hyrat, shpenzimet dhe fitimin apo humbjen para tatimit nga operacionet e ndërprera;
  - Fitimi apo humbja e njohur nga matja e vlerës së drejtë minus kostot e shitjës.
  - Shpenzimet përkatëse të tatimit të ndara në:
    - Fitimin ose humbjën nga aktivitetet e zakonshme të operacionit të ndërprerë për periudhën, sëbashku më shumat korresponduese për secilën periudhë të mëhershme të prezantuar;
    - Fitimi apo humbjën nga ndërprerja;

- (iii) Neto rrjedhat e parasë që i atribuohen aktiviteteve operative, investive dhe financiare të operacionit të ndërprerë.

### **Shpalosjet shtesë**

ACDC duhet të shpalosë informatat në vijim në shënimet në periudhën në të cilën grupi i largimit/shitjes është klasifikuar si i mbajtur për shitje:

- (a) një përshkrim të grupit për shitje;
- (b) një përshkrim të fakteve dhe rrethanave që kanë shpër në shitjen e pritshme, dhe mënyrën dhe kohën e pritur të shitjes.